


# EC

MA NDRYSHË

## USHQIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË MJEDIS

Shtator, 2023



# EC MA NDRYSHE

## EC Ma Ndryshe

### Ushqimi dhe ndikimi tij në mjedis

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)

[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi "Ushqimi dhe ndikimi i tij në mjedis" është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve.



# HYRJE

Mirëqenia e popullsisë njerëzore në gjithë botën varet nga funksionimi i sistemeve të natyrës si dhe elementet që na ofron mjedisi duke na siguruar kështu burimet që na nevojiten për jetesë. Por, aktivitetet njerëzore kanë ndikuar ndjeshëm në mjedis, duke çuar në çështje të ndryshme si ndryshimi i klimës, shpyllëzimi dhe ndotja. Mënyra se si ne prodhojmë, konsumojmë dhe disponojmë mallra dhe shërbime, duke përfshirë ushqimin, është një kontribuues i rëndësishëm në këto probleme mjedisore.

Marrëdhënia midis ushqimit dhe mjedisit është komplekse dhe e shumanshme. Sistemet e ushqimit, të cilat përfshijnë prodhimin, përpunimin, paketimin, transportin dhe asgjësimin e ushqimit, janë përgjegjës për një të tretën e emetimeve antropocentrike të gazeve serrë. Këto emetime kontribuojnë në ndryshimin e klimës, që do të thotë se ushqimi dhe ndryshimi i klimës janë gjithashtu të lidhura në mënyrë të pakthyeshme. [1]

Raporti i fundit nga Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) konfirmon se, nëse nuk ndërmerret asgjë lidhur me këto probleme, grumbullimi i vazhdueshëm i gazeve serrë (GHG) në atmosferë do të bëjë që temperaturat të rriten me më shumë se 1.5°C mbi nivelet para-industriale gjatë shekullit të ardhshëm, përkatësisht mos të përmbushet objektivi i vendosur nga Marrëveshja e Parisit për të minimizuar efektet negative të ngrohjes globale. Prandaj, ekziston një nevojë urgjente për të reduktuar në mënyrë drastike emetimin e këtyre gazrave, nëse duam të parandalojmë që pasojat e kësaj ngrohjeje, tashmë të dukshme sot, të mos dalin jashtë kontrollit dhe të shkaktojnë një rritje të incidencës së ngjarjeve ekstreme klimatike (thatësira, valët e të nxehtit, uragane, zjarre pyjore), duke ndërprerë jetën në Tokë (zhdukja e specieve, rënia e rendimenteve bujqësore, rritja e sëmundjeve infektive, konfliktet e armatosura) dhe rritja e incidencës së disa sëmundjeve të lidhura me nxehtësinë e tepërt. [2]

Është e pamundur të ndajmë prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen tonë të ushqimit nga mjedisi ynë. Fatkeqësisht, mënyra industriale ose "konvencionale" e prodhimit të ushqimit shkakton degradim mjedisor në shkallë të gjerë.

[1] <https://www.ecomatcher.com/the-environmental-impacts-of-food-and-diet/#:~:text=Food%20system s%2C%20which%20include%20food,change%20are%20also%20irrevocably%20linked>. (qasur më 13 shtator 2023)

[2] <https://observatoireprevention.org/en/2021/09/07/environmental-impacts-associated-with-food-production/> (qasur më 13 shtator 2023)

Mënyra se si ne prodhojmë dhe konsumojmë ushqimin kontribuon në ndryshimet klimatike globale, efektet e të cilave ushtrojnë një ndikim të madh në sistemin ushqimor. Thatësira, përmbytjet, nxehtësia ekstreme dhe të ftohtit ekstrem po prekin tashmë të mbjellat.

Por përparimet e reja në bujqësinë e qëndrueshme janë të rrënjosura në praktikat rigjeneruese të bazuara në një qasje të tërë ekosistemit. Bujqësia e qëndrueshme investon në mjedisin natyror, në vend që ta varfërojnë atë, duke përmirësuar shëndetin e tokës, sistemet e ujit të pastër dhe biodiversitetin. Qasja e qëndrueshme gjithashtu redukton emetimet e bujqësisë industriale, duke ndërtuar elasticitet mjedisor, duke përshtatur si prodhimin e ushqimit ashtu edhe tokën ndaj ndryshimeve klimatike. [3]

Tjetër problem lidhur me këtë temë është edhe hedhja e ushqimit të pangrënë (mbetjet), e cila mund të duket si një dëm i vogël për planetin kur krahasohet me çështje të tjera, por realiteti është ndryshe. Kur hedhim ushqimin, ne gjithashtu hedhim larg burimet e çmuara që shkuan në prodhimin e këtij ushqimi. Kjo përfshin përdorimin e tokës dhe burimeve natyrore, koston sociale për mjedisin dhe biodiversitetin tonë. Mbetjet e ushqimit përbëjnë një të tretën e të gjitha emetimeve të gazrave serrë të shkaktuara nga njeriu dhe gjenerojnë 8% të gazeve serrë çdo vit. Me këto statistika, ekziston një nevojë e madhe për të reduktuar këtë gjurmë mjedisore.


Ushqimi është një nevojë e pashmangshme e popullatës i cili për arsye të caktuara po ka ndikim negativ në mjedisin jetësor, duke rrezikuar kështu jetën e qenieve të gjalla në tokë. Pra përmes procedurave të lartpërmendura të realizuara në mënyrë të përgjegjshme, i gjithë sistemi ushqimor në mënyrë direkte apo indirekte po ndikon në: rrezikimin/humbjen e burimeve natyrore, ndryshimet klimatike, degradim të tokave dhe rrezikim të biodiversitetit.[4]

Në lidhje me këtë temë EC Ma Ndryshe ka realizuar një hulumtim përmes anketave me qytetarë të Prizrenit, për të kuptuar më shumë mbi njohuritë e tyre në lidhje me ndikimin e gjithë procesit të krijimit dhe konsumit të ushqimit në mjedis dhe shëndetin e tyre. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të shërbej si mjet për avokim drejt kujdesit më të madh ndaj mjedisit dhe të informoj qytetarët më shumë mbi këtë çështje. E në të njëjtën kohë përmes këtij pyetësi janë analizuar qëndrimet dhe shprehjet e qytetarëve në lidhje me këtë problem mjedisor. Në këtë hulumtim janë anketuar gjithsejtë 152 qytetar prej të cilëve 92 ishin gra dhe 60 ishin burra.


[3] <https://foodprint.org/the-total-footprint-of-our-food-system/issues/food-and-the-environment/> (qasur më 13 shtator 2023)

[4] <https://earth.org/how-does-food-waste-affect-the-environment/> (qasur më 13 shtator 2023)


## A MENDONI SE SHPËRDORIMI I USHQIMIT PO NDIKON NË NDOTJEN E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE?




## NËSE PO, CILAT NGA KËTO PROCESHE TË KRIJIMIT TË USHQIMIT MENDONI QË KANË MË SHUMË IMPAKT NË MJEDIS DHE NË NDRYSHIMET KLIMATIKE?




## CILAT MENDONI SE JANË ARSYET KRYESORE PSE NDODH SHPËRDORIMI I USHQIMIT?




## A KENI NJOHURI SE PERVEÇ SHPËRDORIMIT TË USHQIMIT DHE LLOJET E PAKETIMIT TË USHQIMEVE KANË IMPAKT NEGATIV NË MJEDIS (MATERIALET QË NUK JANË TË RICIKLUESHME ME PËRBËRJE PLASTIKE, JOORGANIKE)?




## NËSE PO, SA JENI TË VËMENDSHËM MBI PAKETIMIN E USHQIMIT GJATË BLERJEVE QË JU REALIZONI NË DYQANE?




## A KENI NJOHURI SE NË NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE NË NDOTJE TË MJEDISIT PËRVEÇ TJERASH NDIKON KONSIDERUESHËM DHE EKSPORTIMI (TRANSPORTI) I USHQIMEVE NGA VENDE TË TJERA?




## SA JENI TË VËMENDSHËM GJATË BLERJEVE TUAJA TË ZGJEDHNI PRODHIME VENDORE?




## A KENI DËGJUAR NDONJËHERË PËR KOMPOSTIMIN E USHQIMEVE ORGANIKE?




## NËSE PO, A E PRAKTIKONI ATË NË SHTËPITË TUAJA?



## A PROVONI JU TË REDUKTONI SHPËRDORIMIN E USHQIMIT?



## A E KONSIDERONI TË RËNDËSISHËM REDUKTIMIN E SHPËRDORIMIT I USHQIMIT?





## PËRFUNDIME

Bazuar në rezultatet e dala nga ky hulumtim, shpërdorimi i ushqimit është shumë i qartë dhe njihet si koncept nga qytetarët e Prizrenit. Problemi qëndron në zgjedhjet dhe kujdesin e qytetarëve sa i përket blerjeve dhe sa i përket kujdesit që ata i kushtojnë mbetjeve ushqimore pas konsumit. Qytetarët po ashtu kanë njohuri mbi efektin e paketimit dhe transportit të ushqimit në mjedis, por përsëri duhet shtuar kujdesi gjatë blerjeve, pra duhet përzgjedhur ushqimi me paketime të riciklueshme dhe u duhet dhënë përparësi ushqimeve vendore.

- Në lidhje me ndikimin e shpërdorimit të ushqimit në ndotjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike 90% qytetarëve të Prizrenit janë shprehur se PO ky proces ka ndikim në mjedis dhe ndryshime klimatike, teksa 7% dhe 3% e qytetarëve janë shprehur me JO dhe Nuk e di.
- Qytetarët që janë përgjigjur me PO në pyetjen e lartë shënuar më tutje janë pyetur se cilat procese nga sistemi i krijimit të ushqimit mendojnë se ka më shumë ndikim në mjedis dhe ndryshime klimatike. Sipas 52% e të intervistuarve, mënyra se si përpunohet ushqimi është parë si problem më madhor, 41% të tjerë si problem e kanë konsideruar fazën se çka ndodh me ushqimin pas konsumit, 34% qytetarë si shqetësuese e shohin edhe paketimin e ushqimit, sipas 24% të tjerëve mendojnë se edhe lloji i ushqimit që konsumohet ka rol në këtë aspekt, 20% të tjerë konsiderojnë problem mënyrës se si është rritur (formuar) ushqimi, ndërsa për 18% të tjerë transporti i ushqimit po ashtu konsiderohet si një indikator negativ në mjedis dhe ndryshime klimatike, gjersa vetëm 5% e qytetarëve kanë pohuar se asnjë nga këto procese nuk kanë ndikim në mjedis dhe ndryshime klimatike.
- Në vazhdim, qytetarët janë pyetur se cilat janë arsyet se pse ndodh shpërdorimi i ushqimit, ku 47% e tyre janë shprehur se blerja e ushqimit pa planifikim është një nga arsyet kryesore, 35% kanë parë si problem në këtë rast mungesën e njohurive të qytetarëve mbi ndikimin që shpërdorimi i ushqimit ka në mjedis, derisa 30% e qytetarëve si arsye tjetër e shohin edhe skadimin e afatit të përdorimit të ushqimit.
- Në pyetjen se a kanë njohuri që përveç shpërdorimit të ushqimit dhe llojet e paketimit të ushqimeve kanë ndikim negativ në mjedis (materialet që nuk janë të riciklueshme me përbërje plastike, joorganike), 82% qytetarë janë shprehur se PO kanë njohuri, 13% kanë dhënë përgjigjen Nuk e di dhe vetëm 5% kanë treguar se JO nuk kanë njohuri.

- Qytetarët që në pyetjen e lartë shënuar janë përgjigjur me PO janë pyetur se sa janë të vëmendshëm mbi paketimin e ushqimit gjatë blerjeve që ata realizojnë në dyqane. Në këtë rast 57% e qytetarëve kanë treguar se deri diku i kushtojnë vëmendje, 29% i kushtojnë shumë vëmendje dhe 14% qytetarë të tjerë kanë treguar se nuk i kushtojnë vëmendje.
- Qytetarët janë pyetur se a kanë njohuri për ndikimin që ka eksportimi (transporti) i ushqimeve nga vende të tjera në mjedis dhe ndryshime klimatike. Në këtë rast 74% e qytetarëve kanë thënë se PO transporti i ushqimit luan rol në degradimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike, 13% të tjerë mendojnë që JO nuk ka ndikim dhe 13% të tjerë kanë zgjedhur opsionin Nuk e di.
- Sa i përket pyetjes se sa janë të vëmendshëm gjatë blerjeve për të zgjedhur produktet vendore. 45% e qytetarëve kanë treguar se deri diku i kushtojnë vëmendje, 42% të tjerë kanë treguar se i kushtojnë vëmendje dhe kanë prioritet në blerjet e tyre produktet vendore dhe vetëm 14% të tjerë kanë thënë se nuk i kushtojnë vëmendje prejardhjes së ushqimit gjatë blerjeve.
- Kompostimi i mbetjeve organike të ushqimit është një proces me shumë rëndësi sa i përket zvogëlimit të mbetjeve ushqimore, andaj përmes këtij pyetësori qytetarët e Prizrenit janë pyetur se a kanë njohuri për kompostimin e mbetjeve ushqimore, në këtë rast 65% e qytetarëve kanë thënë se PO kanë dëgjuar për kompostimin, 23% të tjerë kanë thënë se JO nuk kanë dëgjuar dhe 13% e qytetarëve kanë zgjedhur opsionin Nuk e di.
- Qytetarët që janë përgjigjur se PO kanë dëgjuar për procesin e kompostimit në vijim janë pyetur se a e praktikojnë atë në shtëpitë e tyre, e në këtë rast 53% e qytetarëve kanë thënë që JO nuk e praktikojnë dhe 47% të tjerë treguan që PO e praktikojnë.
- Po ashtu, 48% e qytetarëve kanë pohuar se ndonjëherë provojnë të reduktojnë shpërdorimin e ushqimit, 33% qytetarë shpesh provojnë të reduktojnë shpërdorimin e ushqimit, teksa 15% kanë treguar se kujdesen gjithmonë të mos e shpërdorojnë atë dhe 4% kanë treguar se kurrë nuk kujdesen të mos e shpërdorojnë ushqimin.
- Sipas 58% e qytetarëve, reduktimi i shpërdorimit të ushqimit është me shumë me rëndësi, 29% të tjerë këtë proces e vlerësojnë deri diku të rëndësishëm, 11% prej tyre e shohin si pak të rëndësishme dhe vetëm 2% e tyre e vlerësojnë si aspak të rëndësishme.

## REKOMANDIME

Prodhimi, transporti dhe konsumi i ushqimit kanë ndikim të madh në mjedis. Për të zvogëluar ndikimin e konsumit të ushqimit në mjedis, mund të ndërmarrim masa si reduktimi i konsumit të mishit, zgjedhja e ushqimit të prodhuar në mënyrë të qëndrueshme, zvogëlimi i mbetjeve ushqimore, dhe përdorimi i praktikave të bujqësisë së qëndrueshme.

Në përgjithësi, konsumi i ushqimit është një element kyç i ndikimit tonë në mjedis, dhe vendimet tona rreth zgjedhjes së ushqimit kanë pasoja të rëndësishme për planetin dhe shëndetin tonë.

Sipas përfundimeve të dala nga ky hulumtim, problemi qëndron në zgjedhjet dhe kujdesin e qytetarëve sa i përket blerjeve dhe se sa kujdesen për mbetjet ushqimore pas konsumit. Por përsëri rekomandohet që ata të jenë më të kujdesshëm duke:

- Zgjedhur ushqim më të qëndrueshëm: pra duke zgjedhur ushqim të prodhuar në mënyrë të qëndrueshme, duke përfshirë produktet vendore, organike dhe ato që kanë më pak ndikim në mjedis.
- Marr masa për të zvogëluar mbeturinat: të përdoren komposterët, blerja e produkteve të pa-ambalazuara, dhe praktikave të ushqimit zero mbeturina.
- E rritur edukimin mjedisor: përmes ndërgjegjësimit mjedisor në lidhje me ndikimin e ushqimit në mjedis dhe zgjedhjet e qëndrueshme të ushqimit.

Rëndësi të veçantë kësaj teme i duhet kushtuar edhe nga ana e institucioneve vendore të cilave u rekomandohet që të marrin masa përmes:

- Promovimit të bujqësisë së qëndrueshme dhe ushqimit lokal: duke inkurajuar prodhimin vendas të ushqimit dhe duke ofruar ndihmë financiare për fermerët që praktikojnë bujqësinë e qëndrueshme.
- Përmirësimit të infrastrukturës së transportit të ushqimit: duke bërë ndërtimin e rrugëve dhe rrjeteve të transportit që lehtësojnë qasjen e produkteve vendore në qytete, e cila do të ndihmojë në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit nga transporti i ushqimit.
- Investimit në edukim dhe ndërgjegjësim të qytetarëve: duke organizuar fushata mjedisore në shkolla dhe komunitete për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me ndikimin e ushqimit në mjedis.
- Rregullimit të legjislacionit dhe politikave të qëndrueshme: duke krijuar politika dhe legjislacion që inkurajojnë prodhimin dhe konsumin e ushqimit të qëndrueshëm, duke përfshirë taksa ose ulje të taksave për ushqimin që ka ndikim të ulët në mjedis.

## Për EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.